

HUAZIMET TURKE NË STUDIMET E EQREM ÇABEJIT

Liridona Bërkolli*

Abstrakt

Në mesin e shumë studimeve dhe trajtesave gjuhësore e kulturore të Eqrem Çabej, zë vend edhe trajtimi i huazimeve turke në gjuhën shqipe. Ky shkrim për objekt të studimit ka analizimin e qasjes dhe metodave të tij për trajtimin, klasifikimin dhe studimin e turqizmeve. Në këtë punim gjithashtu do të analizohen edhe aplikimet e ideve dhe propozimeve të Çabejit për studimin e huazimeve turke në gjuhën shqipe. Ndryshe nga bashkëkohësit e tij, Çabej refuzoi të adoptojë perspektivën puriste dhe pranon një studim objektiv të ndikimit të gjuhës turke në atë shqipe. Nga studimet e Çabejit vërehet gjithashtu se, për dallim nga studiuesit “puristë”, ai ka pasur një qasje të ekuilibruar sa i përket elementeve turke në gjuhën shqipe. Refuzimi i konservatizmit gjuhësor dhe angazhimi i tij për analizë objektive kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në diskursin shkencor, duke nxitur një eksplorim më të gjerë të marrëdhënieve komplekse midis gjuhëve. Çabej gjithashtu hap shtigje për studime të tjera në lidhje me huazimet turke, sidomos në fushën e folklorit, si dhe hedh idenë për hulumtime më të gjera rreth ngjashmërive ose prejardhjes orientale të përrallave shqipe.

Fjalë kyçe: *Eqrem Çabej, huazimet turke, gjuha shqipe, gjuha turke, Gadishulli Ballkanik*

* MA Ass. në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, Departamenti i Orientalistikës, ORCID nr: 0000-0001-5162-0603,
e-mail: liridona.berkolli@uni-pr.edu.

TURKISH BORROWINGS IN THE STUDIES OF EQREM ÇABEJ

Abstract

Among the numerous linguistic and cultural studies of Eqrem Çabej, his investigation of Turkish loanwords in the Albanian language holds a key position on Albanian studies. This paper aims to analyze his approach and methodologies for addressing, classifying, and studying these loanwords.

Çabej rejected adopting a purist perspective, advocating instead for an objective study of the influence of Turkish on Albanian. His studies reveal a balanced approach to Turkish elements in the Albanian language, setting him apart from the “purist” scholars of his time. His rejection of linguistic conservatism makes a substantial contribution to scientific discourse, supporting an expanded analysis of the dynamics between languages.

Moreover, Çabej opens pathways for further studies on Turkish loanwords, particularly in the field of folklore. He also proposes broader research into the similarities or Oriental origin of some Albanian folktales.

Keywords: *Eqrem Çabej, Turkish loanwords, Albanian, Turkish, Balkan.*

Hyrje

Studimet mbi huazimet turke në gjuhën shqipe përfshijnë një rrjet të pasur të hulumtimit që hyn në ndërveprimet gjuhësore, ndikimet historike dhe shkëmbimet kulturore midis turqishtes dhe shqipes. Ky shqyrtim përfshin studime që shtrihen në disa dekada, duke pasqyruar interesin e vazhdueshëm në identifikimin e fjalëve të huaja dhe ndikimin e tyre në gjuhën shqipe. Studimi i turqizmave në gjuhën shqipe, dhe më gjerësisht ekzaminimi i ndikimeve gjuhësore dhe ndërveprimeve midis turqishtes dhe shqipes, ishte në fokusin e shumë studiuesve në fushën e albanologjisë (Çabej, 1975); (Boretzky, 1975); (Mulaku,

1977); (Kostallari, 1978); Çabej (1986), (Mehdiu, 1989); (Latifi-Xhanari, 2012); (Xhafçe, 2021) etj. Studiuesit dhe hulumtuesit e kësaj fushë kanë shqyrtuar aspektet historike, kulturore dhe gjuhësore të kontaktit gjuhësor dhe huazimit të fjalëve.

Duke filluar me kontaktet e para të shqiptarëve me popujt e Perandorisë Osmane, për të vazhduar me ndikimin apo gjurmët që kanë mbetur nga bashkëjetesa e këtyre popujve, kontaktet kulturore dhe gjuhësore midis shqiptarëve dhe popujve të Lindjes, për shumë kohë ishin dhe mbeten objekt studimi në studimet dhe trajtesat e studiuesve shqiptarë dhe atyre të huaj. Perëndimi dhe Lindja më tepër se sa emërtime drejtimesh a vendesh gjeografike, kanë marrë kuptime të dy koncepteve që kanë të bëjnë me kulturat dhe qëndrimet ndaj botës dhe jetës.

Konceptet Perëndim dhe Lindje nga studiuesit janë trajtuar në rrafsh të ndryshme shkencore, qoftë në rrafshin e studimeve kulturore në përgjithësi, qoftë në ato albanologjike në veçanti. Nëse Saidi (1978) dhe Todorova (1997) tregojnë mënyrën e konstruktimit të “Lindjes” dhe “lindorit” në diskursin perëndimor, në të kundërtën, Maloqi (2003) ka një diskurs orientalist (në kuptimin saidian) se është Lindja ajo që e ka lënë shqiptarin të prapambetur. Ndërsa Schmitt (2012), Lindjen dhe Perëndimin të shqiptarët i trajton me një qasje neutrale dhe përshkruan rolin e ndërmjetëm që luajtën shqiptarët midis Lindjes dhe Perëndimit. Në mesin e këtyre studiuesve që kanë trajtuar dy konceptet Lindje dhe Perëndim, është dhe Eqrem Çabej. Këtë temë, Çabej e shtron gjerësisht në librin e tij “Shqiptarët midis Lindjes dhe Perëndimit”. Ky i fundit, në objekt të hetimeve të tij ka pozitën gjeografike, historike, kulturore të Shqipërisë dhe shqiptarëve midis influencave të mëdha që rezultonin nga pushtuesë perëndimorë dhe lindorë.

Në këtë punim analizohen qëndrimet e Eqrem Çabejit mbi ndikimin e gjuhës turke në gjuhën shqipe, pa u thelluar në studimet e shkrimet e studiuesve të tjerë mbi marrëdhëniet shqiptaro-turke dhe kontaktet gjuhësore. Por, për të ofruar një pasqyrë më të mirë të këtyre qëndrimeve fillimisht janë vëzhguar qëndrimet e përgjithshme të këtij të fundit, mbi raportet e shqiptarëve me kulturën turke dhe gjurmët që

la pas bashkëjetesa e shqiptarëve me popujt e tjerë në Perandorinë Osmane. Në përgjithësi, do të bëhet përpjekje të hetohet perspektiva e Çabejit mbi raportet shqiptaro-turke për të kuptuar më shumë rreth ideve që ai hedh për trajtimin dhe përdorimin e turqizimeve në gjuhën shqipe. Kështu, pasi të jenë paraqitur trajtesat dhe shkrimet e tij mbi kontaktet e shqiptarëve me Perandorinë Osmane dhe shtrirjen e ndikimit kulturor të kësaj të fundit në territoret e populluara me shqiptarë, punimi do të fokusohet në paraqitjen e analizave dhe hetimeve që u bën Eqrem Çabej turqizimeve në gjuhën shqipe dhe qëndrimin e tij mbi përdorimin e tyre.

Kontaktet e para fizike midis shqiptarëve dhe turqve

Ky kapitull synon të shqyrtojë në përgjithësi ndikimin shumëdimensional të kontakteve të shqiptarëve me Perandorinë Osmane. Me fokus të veçantë mbi qëndrimet e Eqrem Çabejit mbi këtë ndërveprim dhe pasojat që la në praktikën kulturore, besimet fetare e veçanërisht në zhvillimet gjuhësore.

Shqipëria ka pasur fatin që të luajë rolin e një ure lidhëse ose të një zone në të cilën, pa dashjen e saj, janë përleshur ose ballafaquar pushtuesit nga Lindja dhe Perëndimi. “Pushtuesit perëndimorë kanë për qëllim sundimin mbi Gadishull me pikë të fundit Konstantinopolin: Roma, Venediku, Normanët dhe Anjou-të”. Lindorët: bizantinë, gotë, bullgarë, serbë e osmanë duan të arrijnë daljen politike në Adriatik, e nganjëherë, si gotët, bizantinët dhe osmanët nën Muhamedin II, duan ta përdorin Shqipërinë si dërrasë kërcimi për në Itali. Ky qëndrim i ndërmjetmë midis Perëndimit e Lindjes, i bashkuar me ruajtjen e ngulitur të natyrës së vet etnike, i ka gdhendur Shqipërisë përgjithmonë fytyrën e saj të veçantë” (Çabej, 1986).

Sipas Çabej, perëndimorët nuk kanë pasur qëllim kryesor pushtimin e Shqipërisë, por atë e kanë përdorur si një urë për të arritur deri në Konstantinopojë (Stambolli i sotëm). Të njëjtin qëndrim e mban edhe sa i përket lindorëve, të cilët, Shqipërinë e kanë shfrytëzuar për të dalë në detin Adriatik dhe Itali. Nga këto konstatime të Çabejit hetohet një qasje pasivizuese e shqiptarëve në zhvillimet historike. Pra, pozita gjeografike e Shqipërisë ka përcaktuar orientimet kulturore të

shqiptarëve. Njëri nga këto orientime që ia caktoi pozita gjeografike popullit shqiptar ishte ai oriental, i cili la gjurmë të dukshme në fusha të ndryshme të jetës së popullit shqiptar. Sipas Çabej, ndikimi oriental ka arritur të depërtojë edhe në pjesët më rurale të shoqërisë shqiptare, gjurmët e të cilit mund t'i vërejmë sot e kësaj dite.

Ndërsa në lidhje me kontaktet e para fizike midis shqiptarëve dhe turqve, Çabej është i mendimit se ky kontakt së pari u realizua me ushtarët mercenarë turq që kishin ardhur si pjesë e ushtrisë së perandorit bizantin, Androniku III Paleologu me rastin e një ekspedite të tij në Shqipëri në vitin 1330. Sipas Çabej, “kjo ndeshje e parë turko-shqiptare ka rëndësi dhe për gjuhësinë, se na bën të mendojmë që ndikimi i turqishtes në shqipen ka nisur që përpara sundimit të vendit” (Çabej, 1986, fq. 64-65). Elementi tjetër që e ka vërejtur Çabej është dhe dallimi që ai e bën ndërmjet Perandorisë Bizantine dhe Perandorisë Osmane me Perandorinë Romake. Perandoria Romake, sipas Çabej, me pushtimin e vendeve të tjera, përfshirë edhe Shqipërinë, synonte vetëm sundimin politik dhe ushtarak, kurse perandoritë bizantine dhe osmane, përveç këtyre synimeve, kanë bërë përpjekje që popujt të cilët i pushtonin, t'i njësonin me fetë dhe kulturat e tyre. Për atë dhe këto dy perandori kanë lënë gjurmë të mëdha kulturore nëpër ato vende dhe popuj që i kanë sunduar.

Siç shprehet edhe vetë Çabej, në pikëpamje gjeografike pozita e ndërmjetme e Shqipërisë midis Perëndimit dhe Lindjes, jo vetëm që ka caktuar rrugën e historisë dhe ka ndikuar në ndarjen e feve, por ajo i ka dhënë drejtim edhe literaturës. Çabej shkruan se përhapja e fesë islame në Gadishullin Ballkanik dhe në Shqipëri, është bërë shkallë-shkallë dhe ka zgjatur për disa shekuj dhe si rezultat i përhapjes së këtij besimi të ri, i ka dhënë shkaqe edhe zgjerimit të përdorimit të gjuhës turke dhe ngulitjes së fjalëve turke në gjuhën shqipe (Çabej, 1986, fq. 65). Gjuha, si pjesë jetike e identitetit kulturor, përjetoj zhvillime gjatë kontaktit të shqiptarëve me Perandorinë Osmane. Ndalimi osman la një shenjë të pashlyeshme në gjuhën shqipe, veçanërisht përmes përdorimit të fjalëve turke dhe nuancave gjuhësore.

Mbi huazimet turke në gjuhën shqipe

Turqizmat dhe përdorimi i tyre në gjuhën shqipe janë studiuar nga perspektiva të ndryshme, nga studiuesit e shumtë që janë marrë me këtë fenomen. Shumë studiues i kanë trajtuar në kontekstin e pastrimit të gjuhës. Nga ana tjetër kemi edhe studiues që kanë treguar një qëndrim më deskriptiv duke i mbledhur, klasifikuar, analizuar si njësi të veçanta gjuhësore.

Studimet me fokus në turqizma fillojnë me studimet e Franc Mikloshiq, i cili hulumtoi ngjashmëritë dhe dallimet midis huazimeve turke në gjuhën e Ballkanit. Gustav Meyer është marrë me etimologjinë e fjalëve shqipe, ku si rezultat i studimit të tij është *Etymologisches Wörterbuch der Albanesischen Sprache* (Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe) (1891), në të cilin ai numëron gjithsej 5140 fjalë turke të identifikuara në gjuhën shqipe. (në Çabej 1976:69) Më vonë janë bërë studimet mbi përshtatjen e turqizmeve në shqipen nga ana e Boretzky (1975), me studimin dy vëllimësh, i pari *Der Türkische Einfluss auf das Albanische*, ku përpunohen fonologjia dhe morfologjia e turqizmeve të gjuhës shqipe dhe i dyti *Wörterbuch der Albanischen Türzismen* ku jepet një korpus i gjerë i turqizmeve si dhe listat e veçanta të turqizmeve në tre dialekte të shqipes (dialekti i Dibrës, Preshevës dhe Drenicës) (Xhafçe, 2021).

Në anën tjetër, Eqrem Çabej i zgjeron studimet mbi këtë fushë duke u fokusuar me shtrirjen kronologjike të futjes së huazimeve turke në gjuhën shqipe. Kështu, ai fillon duke shtruar pyetjet se cilat huazime kanë hyrë më përpara e cilat më vonë, si dhe “a mund të caktohet përafërsisht koha e depërtimit të tyre?” (Çabej, 1975, fq. 79). Kështu, ky i fundit ofron një kronologji të huazimeve turke në gjuhën shqipe. Po ashtu, Çabej (1976) përmend një kontroll statistik të të dhënave gjuhësore dhe një vështrim historik të fakteve gjuhësore.

Duke iu qasur me një perspektivë më përshkruese, me turqizmat u morën edhe Latif Mulaku (1977), Androkli Kostallari (1978) e Fetih Mehdiu (1989), të cilët trajtuan hyrjen dhe depërtimin e turqizmeve në gjuhën shqipe.

Krahas studimeve të bëra mbi huazimet turke, studiuesit si Krajni, Lafe e Demiraj prapë përmendin mangësi në studimet në këtë fushë.

Krajni (1965) referon vëzhgimin mbi ndryshimet që kanë pësuar huazimet turke sipas ligjeve fonetike e morfologjike të shqipes në të gjithë zonën e përhapjes gjeografike të saj, Lafe (1993) konstaton se ka nevojë për një vështrim të përgjithshëm me qëllim të krahasimit të turqizmeve në gjuhët ballkanike. Ndërsa Demiraj (2004), edhe pas punës së Tahir Dizdarit *Fjalor i orientalizmeve në gjuhën shqipe*, thekson se nuk kemi një numër të saktë të huazimeve në shqipen e sotme standarde dhe nëpër të folmet e ndryshme popullore. Punë të cilën më pas është munduar ta bëjë edhe Lindita Xhanari Latifi në fjalorin “Fjalor i turqizmeve të përbashkëta të gjuhëve ballkanike”.

Përveç çështjes së numrit të huazimeve turke dhe kohës se kur kanë hyrë në gjuhën shqipe, janë trajtuar edhe aspekti stilistiko-semantik (Desnickaja, 2006) dhe ai semantik (Latifi-Xhanari, 2012). Ndërsa, Anila Omari (2016) ofron kontributin e saj mbi përdorimet e huazimeve turke të autorët e vjetër, duke rreshtuar 86 huazime turke të vepra e Bogdanit.

Mejer (1891) dhe Škaljić (1966), fjalët turke në gjuhët ballkanike i kanë emërtuar si “turqizma” dhe shkruajnë se fjalët arabe dhe perse në këto gjuhë kanë depërtuar nëpërmjet gjuhës turke, për atë dhe duhet të quhen “turqizma”. Në anën tjetër, Bajraktararević (1966) dhe Desnickaja (1963) kanë shprehur idenë se këto fjalë duhet të quhen “orientalizma”, ngase me “turqizma” kuptohen jo vetëm fjalët thjesht turke, por gjithashtu dhe ato arabe dhe perse, që kanë depërtuar në shqipe nëpërmjet turqishtes ose drejtpërdrejt nga arabishtja dhe persishtja, njohja e të cilave ishte e përhapur mes pjesës së arsimuar të popullsisë myslimane të Shqipërisë së Vjetër. Ndërsa në shkrimet e Çabejit nuk gjejmë ndonjë trajtesë rreth termit që do të shënjonte fjalët turke. Ai u referohet si “huazime turke”, megjithëse është i vetëdijshëm se këto kanë edhe elemente të gjuhës arabe dhe asaj perse.

Në shkrimin “Për një shtresim kronologjik të huazimeve turke të shqipes” Çabej (1975), në fillim identifikon disa probleme dhe hap disa shtigje të studimit të huazimeve turke në gjuhën shqipe. Sipas tij, janë pesë fusha në të cilat, studiuesit duhet t’i trajtojnë huazimet turke.

1. Çështja e shtrirjes gjeografike e huazimeve turke në gjuhët e veçanta të Gadishullit Ballkanik.

Me anë të kësaj, Çabej kërkon që të hulumtohen vendet e rajonit dhe të shihen se në cilën prej gjuhëve ballkanike ose në cilën të folme/varietetet gjuhësor psh. të shqipes, ekzistojnë më shumë huazime turke. Një studim i tillë akoma nuk është bërë në mesin e ballkanistëve dhe orientalistëve.

2. A kanë luajtur rol dallimet fetare dhe sociale të popujve ballkanas në sasinë e huazimeve turke në gjuhët e tyre?

Për këtë temë, Çabej kërkon të hulumtohet nëse, për shembull, boshnjakët ose shqiptarët me shumicë myslimane kanë përdorur më shumë huazime turke sesa serbët, maqedonët, bullgarët, grekët, etj.

3. Gjuhët ballkanike a kanë dhënë apo marrë fjalë dhe elemente turke nga njëra-tjetra?

Çabej në vazhdim të shkrimit të tij ka arritur të japë disa shembuj për disa huazime turke që në shqip kanë hyrë nëpërmjet greqishtes, por kjo mund të hulumtohet nëse gjuhët sllave kanë pasur ndonjë dhënie-marrje fjalësh turke me gjuhë shqipe. Çabej gjithashtu ka propozuar hulumtimin se cilat elemente leksikore kanë hyrë më parë prej turqishtes në gjuhët e tjera të Evropës Juglindore.

4. Ndarja e huazimeve turke në sfera të ndryshme të jetës dhe në fusha të veprimtarisë së përditshme të shqiptarëve.

Vetë Çabej klasifikon fushat në të cilat ka ndikuar më tepër gjuha turke. Sipas tij, më së shumti fjalë turke gjejmë në fushat si: shtëpia dhe orënditë shtëpiake, kuzhina; veshja; tregtia e trafiku, zejtaria, jeta e tregut; jeta botore (publike) sociale e politike, administrata, drejtësia; jeta fetare; sfera e luftës; emra bimësh dhe shtazësh ekzotike; emra vendesh e popujsh (Çabej, 1975, fq. 84).

5. Caktimi i një kronologjie në marrjen e këtyre elementeve leksikore turke në gjuhën shqipe.

Çabej, më pas studimin e tij e thellon duke sjellë disa argumente dhe shembuj për të identifikuar një kronologji të huazimeve turke në gjuhën shqipe. Ai shkruan:

“Kjo çështje (caktimi i kronologjisë së huazimeve turke) për mua përfshin dy pika të veçanta. E para: Cilat huazime kanë hyrë më përpara, cilat më vonë? (kronologji relative). E dyta: A mund të caktohet përafërsisht koha e depërtimit të tyre? (kronologji absolute). Me këtë do të lidhej edhe çështja tjetër nëse të njëjtat huazime turke kanë hyrë afërsisht njëkohësisht në këto gjuhë” (Çabej, 1975:79).

Çabej gjithashtu llogaritet i pari që ka arritur të bëjë një periodizim të huazimeve turke në gjuhën shqipe. Ai propozoi tri faza:

Faza e parë: Periudha para shek. XV që dëshmohe vetëm me anë të fondit leksikor arbëresh.

Sipas tij, dija për gjuhën shqipe është e favorshme për të kryer studime rreth shtresimeve të huazimeve turke dhe madje mund të strukturohet edhe një kronologji relative, por edhe një kronologji absolute. Për të vendosur një kronologji të tillë për huazimet turke, Çabej hulumtimin e tij e drejton kah e folmja e shqipes në mesin e arbëreshëve të Italisë.

“Në këtë mes do pasur parasysh fakti që këto ngulime pas vendosjes tyre (arbëreshëve) në trojet e Italisë i humbën një herë e përgjithmonë lidhjet me atdheun e vjetër prej nga u shkulën; shumë-shumë mund të ketë depërtuar në to ndonjë element i veçuar turk (ose përgjithësisht oriental, sidomos arab) me anë të mjedisit italian që i rrethon. Për këtë arsye elementet turke të këtyre idhujve gjuhësorë mund të përdoren me dobi për një kronologji (të huazimeve turke)” (Çabej, 1975, fq. 80)

Çabej argumenton se rrethanat historike me të cilat u përballën shqiptarët pas pushtimeve turke, sidomos ikja e një pjese të shqiptarëve nga rajoni dhe vendosja e tyre në Greqi dhe Itali, ka ndikuar që ata të ruajnë varietetin e hershëm të shqipes. Dhe ne sot, duke hulumtuar të folmet arbëreshe të Italisë, Greqisë, por edhe të Zarës, mund të identifikojmë huazimet e hershme turke në gjuhën shqipe, dhe në këtë mënyrë të caktojmë një kronologji të depërtimit të këtyre fjalëve në shqip. Kështu Çabej duke u bazuar në disa korpuse të shkruara si *Fja-*

lori etimologjik i Gustav Meyerit, i cili ka listuar të dhëna nga M. Lambertz, G. Rohlf, E. Giardianos, si dhe në gjurmimet e tij individuale që i ka zhvilluar në Sicili, përgatitë një listë me huazime turke që i përkasin shtresës më të vjetër.

Ndërsa, sipas Mandala-s, burimet që përdori Çabej për arbërishten nuk janë gjithherë të sigurta dhe në shkrimin e tij ai ka bërë disa saktësime në këtë drejtim. Këtij periodizimi kronologjik iu kanë përmbajtur edhe studiet pas Çabej, siç janë Krajni (1965) dhe Kostallari (1978). Ndërsa studimet në lidhje me huazimet turke nga arbëreshët i kanë çuar më tej edhe Bardh Rugova dhe Maksimiljana Barançiq, me hulumtimin e tyre “Turcizmat në të folmen e arbëreshëve të Zarës”. Ky studim në fokus ka përdorimin e turcizmave në arbërishten e sotme në qytetin e Zarës. Barançiq (2012) numëron 14 sosh, kurse (Rugova & Barançiq, 2017: 262) shprehen se “gjatë ekspeditës (së tyre), ndërkaq, janë identifikuar edhe dy fjalë që mund të kenë origjinë turke: karakoç (me variantet e tjera karaguç dhe karaguj) dhe karma”.

Faza e dytë: Periudha nga shek. XVI deri në gjysmën e dytë të shek. XVIII, që përkon me periudhën më intensive të pushtimit osman të Shqipërisë e që dokumentohet përmes veprave të Buzukut (1555), Budit (1618); (1621), Bardhit (1635), Bogdanit (1685), Kuvendit të Arbënit (1706), Fjalorit (1702) dhe Gramatikës (1716) së Da Leçe-s, si edhe të veprave të tjera të mbetura në dorëshkrim. Sipas Çabej, burimet letrare shqipe të kësaj faze janë shumë më të pasura me huazime turke në krahasim me fazën e mëhershme. Kështu, ai identifikon turqizmat të Buzuku dhe Budi, që në krahasim me Pjetër Bogdanin, i kanë përdorur shumë më pak ato. Ai në shkrimin “Huazimet turke” i ka renditur këto huazime të Bogdanit dhe ato i klasifikon sipas disa sferave: jeta shtëpiake, petkat e tualeta, jeta shoqërore, jeta shtetërore, administrata dhe jeta ushtarake. Dhe për secilën sferë sjellë fjalët turke të përdorura në *Çeta e Profetëve* (1685) të Pjetër Bogdanit.

Faza e tretë: periudha që mbulon gjithë shekullin XIX deri në parësorinë e Shqipërisë (1912) e që nga pikëpamja e dëshmimit me shkrim është pa dyshim më e pasura. (Çabej, 1986, fq. 275-278). Rili-

ndasit shqiptarë patën filluar një ndërmarrje për pastrimin e gjuhës shqipe nga fjalët turke dhe kjo vërehet sidomos në shkrimet dhe botimet e përgatitura nga Jani Vreto.¹ Kjo lëvizje e rilindasve vazhdoi edhe më vonë, sidomos studiuesit Krajni (1965) dhe Kostallari (1978) kanë mbajtur qëndrime të ashpra kundrejt këtyre huazimeve turke dhe kanë këmbëngulur për eliminimin dhe zëvendësimin e tyre me fjalë të tjera.

Eqrem Çabej këtë luftë e konsideron të tepruar në rrethanat e kohës së tij. Ai shkruan: “Nuk duhet harruar se shumë huazime turke kanë hyrë në gjuhën popullore, dhe si të tilla nuk ka si të hiqen nga përdorimi. Ajo që është më keq, është se ata që kanë luftuar këto fjalë shpeshherë i kanë zëvendësuar me të tjera fjalë të burimit të huaj, duke kujtuar se me mënjanimin e turqizimeve i ndihmohej pastrimit të gjuhës” (Çabej, 1986, fq. 69).

Ai gjithashtu drejton kritika kundrejt atyre që mbrojnë idenë se huazimet greke dhe italiane qëndrojnë më lartë nga pikëpamja objektive shkencore kundrejt fjalëve turke. Sipas Çabej, një dallim i tillë kualitativ midis gjuhës është i padrejtë dhe i pavend.

“Mund të thuhet përgjithësisht se zhvillimi i shqipes moderne karakterizohet nga një pakësim i elementit turk e nga një shtim i elementit italian. Me këtë rrugë pastrimi i gjuhës nga byku i huaj nuk ka fituar asgjë. Janë të tjera rrugë që shpien në pastërtinë e gjuhës” (Çabej, 1986, fq. 69).

Çabej ka vërejtur se ndikimi turk në folklorin shqiptar ka qenë një ndër faktorët kryesorë që kanë shkaktuar huazime e që ka lënë një trashëgimi leksikore e cila nuk mund të zhduket lehtë me përpjekje të jashtme. Sundimi Osman, sipas Çabej, ka sjellur një varg elementesh e motivesh orientale në muzikën popullore, në lëndën e në motivet e

¹ Shembull: Vepra e Muhamet Çamit “*Erveheja*”, e botuar me ndërhyrjen e Jano Vretos dhe krahasimi i saj me transkriptimin e dorëshkrimit të origjinalit nga Ibrahim Hoxha. Shih: Muhamed Çami, Jeta dhe vepra: *Erveheja*, Shkup: Vatra, (2002).

përrallave, në fe dhe figurat e besimeve popullore. Meloditë turke, për shembull, sipas Çabej, “kanë depërtuar në Ballkan që nga koha paraturke me ndërmjetësinë e Bizantit” (Çabej, 1986).

Çabej gjithashtu hap edhe një shteg të hulumtimit shkencor në fushën e studimeve orientale. Ai shkruan se shumë përralla popullore që rrëfehen në Shipëri dhe në vende tjera të rajonit të Ballkanit janë turke ose me prejardhje orientale (Çabej, 1986). Edhe pse Kalessi (1974) ka bërë një studim me titull *Arnavut öykülerinde doğunun etkileri* (Ndikimet e Lindjes në përrallat shqiptare), kjo çështje mbetet shumë pak e hulumtuar.

Përfundim

Në këtë shkrim u trajtuan idetë dhe qasjet e Eqrem Çabej në lidhje me huazimet e fjalëve turke në gjuhën shqipe. Ai dha kontribut të çmuar në kuptimin dhe hulumtimin e mëtutjeshëm të këtyre elementeve në gjuhën shqipe. Studimi i tij i pasuron studimet albanologjike, duket ofruar një analizë objektive shkencore, e cila kundërshton konservatizmin gjuhësor. Në kundërshtim me disa nga bashkëkohësit e tij që shikonin me skepticizëm huazimet turke, Çabeji i pranoi ato si pjesë të padiskutueshme të zhvillimit të gjuhës, duke njohur rolin e tyre në reflektimin e ndërveprimeve historike mes kulturave të ndryshme. Një nga arritjet e dukshme të Çabejit ishte refuzimi i qëndrimeve puriste, të cilat shpesh kishin dominuar diskutimet gjuhësore gjatë kohës së tij. Në vend që t'i përjashtonte huazimet turke nga përdorimi, ai ka kërkuar një kuptim të përgjithshëm të kontributit të tyre në ngjitjen gjuhësore të shqipes. Përqasja e tij e hapur ka mundësuar një eksplorim më të thelluar të peizazhit gjuhësor, duke marrë në konsideratë ndikimet e shumëllojshme që kanë formuar gjuhën shqipe.

Nga shkrimet dhe studimet e tij u identifikuan disa fusha që Çabej i propozon për zhvillimin e mëtutjeshëm të studimeve mbi elementet turke në gjuhën shqipe. Ai ka propozuar katër fusha të përgjithshme: ai kërkon hulumtimin e shtrirjes gjeografike të huazimeve turke në gjuhët ballkanike; studimin e rolit të dallimeve fetare dhe sociale të popujve ballkanik në sasinë e huazimeve turke; trajtimin e dhënies-marrjes të fjalëve turke në gjuhët ballkanike nga njëra-tjetra; klasifi-

kimin e fushave dhe sferave të huazimeve turke në gjuhën shqipe; dhe caktimin e një kronologjie të depërtimit të elementeve turke në gjuhën shqipe.

Pastaj, Çabej hulumtimin e tij e ka thelluar më shumë rreth kronologjisë së hyrjeve të fjalëve turke në shqipe, dhe kështu propozon tri faza: faza e parë, periudha para shek. XV që dëshmohet vetëm me anë të fondit leksikor arbëresh; faza e dytë, periudha nga shek. XVI deri në gjysmën e dytë të shek. XVIII; dhe faza e tretë, periudha që mbulon gjithë shekullin XIX deri në pavarësinë e Shqipërisë (1912).

Nga studimet e Çabejit vërehet gjithashtu se, për dallim nga disa studiuesë të tjerë “puristë” ai ka pasur një qasje të ekuilibruar sa i përket elementeve turke në gjuhën shqipe, dhe ka qenë kundër zëvendësimeve të fjalëve turke me huazime italiane. Çabej gjithashtu hap shtigje për studime të tjera në lidhje me huazimet turke, sidomos në fushën e folklorit, si dhe hedh idenë për hulumtime më të gjera rreth ngjashmërive ose prejardhjes orientale të përrallave shqipe. Studimet e Çabejit kanë vendosur themelet për hulumtimet e mëtejshme në fushën e huazimeve dhe kontakteve gjuhësore. Duke inkurajuar eksplorimin e mëtejshëm të marrëdhënieve komplekse midis gjuhëve, Çabej ka hapur rrugë për vazhdimin e hulumtimit në fushën e ndërveprimit gjuhësor dhe shkëmbimit kulturor.

Literatura:

- Bardhi, F. (1635). *Dictionarium latino-epiroticum*. Romë.
- Bogdani, P. (1685). *Cuneus Proephetarum*. Padovë.
- Buzuku, Gj. (1555). *Meshari*. Venedik.
- Budi, P. (1618). *Doctrina Christina*. Romë.
- Boretzky, N. (1975). *Der Türkische einfluss auf das Albanische*, Wiesbaden: Harrassowitz.
- Barančić, M. (2012). *Leksik arbanaškoga govora u Zadru kaoodraz jezičnih dodira – dorëshkrim i doktoraturës*, Universiteti i Zarës.
- Demiraj, Sh. (2004). *Gjuhësi ballkanike*. Shkup: Focus
- Desnickaja, A. V. (2006). *Mbi funksionin stilistik të turqizimeve në poezinë shqipe*, Perla, Nr. 4(43), fq. 126-134.

- Dizdari, T. (2005). *Fjalor i orientalizmave*. Tiranë: AITCC
- Çabej, E. (1975). *Për një shtresim kronologjik të huazimeve turke*. Në: Studime Filologjike (1), Tiranë.
- Çabej, E. (1986). *Studime Gjuhësore. Vepra 3*. Prishtinë: Rilindja.
- Çabej, E. (2006). *Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes*. Shtëpia botuese: Çabej.
- Miklosich, F. (1870-1871). *Albanische Forschungen*, Bde. I-III, Wien: Kaiserliche Akademie der Wissenschaften
- Krajni, A. (1965). *Hyrja e turqizmeve në shqipen dhe përpjekjet për zëvendësimin e tyre*, Studime Filologjike, 1, fq. 143-151.
- Kostallari A. (1978), *Rreth depërtimit të turqizmeve në gjuhën shqipe gjatë shekujve XVII-XVIII*, Gjurmime Albanologjike, SSHF, Prishtinë.
- Lafe, E. (1980). *Persizmat në kuadrin e orientalizmave të "Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe"*, Perla, Nr.1.
- Latifi-Xhanari, L. (2012). *Turqizmat dhe semantika e tyre në fjalorët e shqipes*. Tiranë: Dudaj.
- Latifi-Xhanari, L. (2019). "Fjalor i turqizmeve të përbashkëta të gjuhëve ballkanike". Tiranë:
- Mehdiu, F. (1989). *Orientalizmat: hyrja dhe përdorimi i tyre në gjuhën shqipe*. Në: Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe. Tiranë: Instituti i Gjuhësisë.
- Meyer, G. (1891). *Etymologisches Wörterbuch der Albanesischen Sprache*. Strasbourg; Trübner
- Mulaku, L. (1977). *Turqizmat në gjuhën shqipe*. Në: Seminari i Kulturës Shqiptare për të Huaj III. Prishtinë.
- Mandala, M. (n.d.). *Mbi turqizmat në të folmet arbëreshe në Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit*, ASHAK.
- Maloki. K. (2003). *Oriental apo Okcidental*. Tiranë: Plejad.
- Omari, A. (2016). *Leksiku i veprës së Pjetër Bogdanit*. Tiranë: QSA
- Rugova, B. Barancic. M. (2017). *Turqizmat në të folmen e arbëreshëve të Zarës*. Studime, ASHAK.
- Said, E. (1978). *Orientalism*. New York, Pantheon Books.
- Skaljic, A. (1966). *Turqizmi u srpskohrvatskom jeziku*. Sarajevë: Svjetlost.
- Schmitt. O. J. (2012), *The Albanians: A story between Orient and Occident*, C.H. Beck, Muchen.
- Todorova, M. N. (1997). *Imagining the Balkans*. New York: Oxford University Press.
- Xhafçe, Z. (2021). *Zhvendosja e regjistrave të turqizmeve në gjuhën shqipe*. (Disertacion i doktoraturës i papublikuar i mbrojtur në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina")